

06-07-2018

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2438-1/17, e dt. 18.12.2017, në praninë e prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, si dhe të pandehurit [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më dt.19.04.2018, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 11.05.2018, përpiloi me shkrim këtë:

## AKT GJYKIM

**I pandehuri:** [REDACTED] i lindur me [REDACTED], me profesion automekanik, i martuar, prind i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal [REDACTED]

## ËSHTË FAJTOR

Me datë 20.11.2017, rreth orës 18:15, në rrugën e fshatit Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj, i pandehuri nga pakujdesia, ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 120 pika 1 të Ligjit për rregullat e trafikut Rrugor, derisa drejtonte automjetin e markës "Mercedes C 220", ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit [REDACTED], nuk ka përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës si dhe duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme të sigurisë me automjetin para tij, nuk arrin të ndalet, me pjesën e përparme të automjetit e godet në pjesën e pasme automjetin e markës "Ford Fiesta", ngjyrë të kaltërt, me targa të regjistrimit [REDACTED] të cilën e drejtonte [REDACTED] i cili i shte ndalur në rrugë, përveç dëmeve në automjete, lëndime të lehta trupore me dëmtime të përkohshme për shëndetin kanë pësuar



██████████ dhe ██████████ të përshkruar sipas ekspertizës mjeko-ligjore të datës 13.12.2017,-.

me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,23,41,42,49,50,51,52,73 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, e

### G J Y K O N

Të pandehurim ██████████ me DËNIM ME GJOBË në lartesi prej 200 Euro /dyqind/, të cilin dënim duhet ta paguaj kur aktgjykimi të mër formën e prerë në afat prej 30 ditësh nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin brenda afatit prej 1 (një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Të dëmtuarit ██████████ dhe ██████████ nga Fshati ██████████ Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 Euro /njëzet e pesë euro / si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumën prej 60.88 Euro /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent), në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë..

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.



## Arsyetimi

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.2438-1/17 dt.18.12.2017 ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], për veprën penale rrezikim i trefikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.04.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë aksident, i kërkon falje publike të dëmtuarit duke shtuar se në ditën e shkakimit të aksidentit ka ndikuar edhe kushtet atmosferike pasi që ndriqimi nuk ka qenë në masën e duhur, i njëjti premtan gjykatës që në të ardhmen do të shtoj kujdesin në komunikacion, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë..*

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: ekspertiza e komunikacionit 08.12.2017, ekspertiza e



mjekut ligjor dt.13.12.2017, deklarata e të dëmtuarve, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut nga neni 378 par 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, baba i tre fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi



**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti Pergjithshem-Divizioni Penal,**  
**P.nr.3236/17 datë 11.05.2018.**


**Zyrtare ligjore,**

**Ganimete Avdiu**



**Gjyqtari:**

**Halile Ilazi**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimi të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.